

**GREEN COAST SH.P.K.**

**RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI**

**L41329038D**

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, më 23.02.2024, në orën 12.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ( këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrin e dyte të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

**I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

\*\*\*\*\*

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 4,509,733,328 LEK (kater miliard e pese qind e nente milion e shtateqind e tridhjete e tremije e treqind e njezete e tete lekë).

Me qëllim zhvillimin e projekteve te Green Coast 2 ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Është vlerësuar e përshtatshme zmadhimi i kapitalit me 3,800,000 Euro (tre milion e tetëqind mijë Euro) e konvertueshme me 394,364,000 LEK (Treqind e nentedhjete e kater milion e treqind e gjashtedhjete e kater mijë Lekë) sipas kursit te këmbimit te publikuar nga Banka e Shqipërisë te datës e mbajtjes se kësaj Mbledhje (**1 euro = 103.78 Leke**)  
Vlera e zmadhimit do te shpërndahen përkatësisht sipas projekteve :

- **Green Coast 2 \_ Nukli L** per vleren 2,800,000 Euro
- **Green Coast 2 \_ Nukli G11** per vleren 1,000,000 Euro

Pas një vlerësimi të kujdeshëm, Asambleja

**VENDOS:**

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 3,800,000 Euro (tre milion e tetëqind mijë Euro) e konvertueshme me 394,364,000 LEK (Treqind e natedhjete e kater milion e treqind e gjashtedhjete e kater mijë Lekë) sipas kursit te këmbimit te publikuar nga Banka e Shqipërisë te datës e mbajtjes se kësaj Mbledhje (**1 euro = 103.78 Leke**),

- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 4,509,733,328 LEK (kater miliard e pese qind e nente milion e shtateqind e tridhjete e tremije e treqind e njezete e tete lekë) do të bëhet 4,904,097,328 LEK (Katermiliard e nenteqind e kater milion e nentedhjete e shtate mijë e treqind e njezete e tete Lekë).

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjeter për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 12.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut te Vetëm te "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**  
**GREEN COAST SH.P.K.**

**KRYETARI**

Znj. Edlira MUKA



**SEKRETARI**

Z. Bers Hado